

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **Trepça SH.A.**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **12997 12998-26-468-1-1-1**

Sa i përket tenderit për: **Furnizim me pajisje personale mbrojtëse në Punë.**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

PROGLOBAL SHPK

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Dardani, Rr. 28 Nentori, LI-2, Lok 129

(Adresa)

Prishtinë

(Vendi)

044148645

(Numri i telefonit)

Latif Imeri

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

info@proglobal-ks.com

(Adresa elektronike)

26.06.2026

(Data e parashtrimit të ankesës)



(Nënshkrimi dhe vula)

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

- Njoftimi për kontrate – 11.02.2026
- Hapja e ofertave – 24.03.2026
- Njoftimi mbi vendimin e AK-se – 02.04.2026
- Kerkesa për Rishqyrtim – 07.04.2026
- Vendimi i OSHP nr. 0242/2026 - 07.05.2026
- Kerkesa për rishqyrtim - 20.06.2026
- Vendimi i Ak-se Refuzimi i kerkeses - 22.06.2026

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

Jo

Hapja e ofertave – 24.03.2026

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

Jo

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po

Jo

Operatori Ekonomik ankues “Proglobal” shpk – Prishtine, me daen 20.06.2026, ka paraqitur kerkese për ri shqyrtim kundër arsyetimit te anulimit te procedurës se prokurimit gjegjesisht kundër arsyetimit te eleminimit ku kemi prezantuar prova dhe dëshmi për shkelje procedurale dhe ligjore por qe AK – Trepca sha perseri refuzon kerkesen tone dhe le ne fuqi vendmin e saje për anulim te procedurës se prokurimit.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Shkeljet ligjore te LPP-se nr. 04/L-042.

Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi

Neni 24 Zyrtarët e Prokurimit gjatë Ushtrimit të aktiviteteve të prokurimit

Neni 52 Njoftimi i kriterëve për dhënien e kontratës

Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve

Neni 62 – Perfundimi i aktivitetit te prokurimit

Rregullorja për Prokurim Publik, 001/2022

Neni 17 Dosja e tenderit

Neni 40 – Ekzaminimi vlereismi dhe krahasimi i ofertave

Neni 97 Shkeljet e renda.

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Te nderuar,

Ky aktivitet i prokurimit ka qene objekt shqyrtimi ne AK – Trepca sh.a. dhe është pasuar ne OSHP, dhe qeshtja e veprimeve kundërligjore te AK-se tani me është gjykuar me vendim te OSHP-se dhe me ekspertizen me nr. 2026/0242, te datës 28.04.2026, janë trajtuar dhe gjykuar pretendmjet tona ankimore ku si rrjedhojë e kesaje oferta jone është kualifikuar si e pergjegjeshme ne tërësi ndërsa oferta e kompanise pjesemarrese Agron Commerce është eliminuar si e pa pergjegjshme ku me datën datën 07.05.2026, është nxjerre vendmi i OSHP-se me nr. OSHP: 2026/0242, dhe AK – Trepca sha është obliguar qe ti zbatoj rekomandimet dhe te gjeturat e ekspertit shqyrtues.

Pavaresisht kesaje ne si kompani me datën 20.06.2026, kemi parashtruar kerkese për ri shqyrtim tek AK, kemi kerkuar zbatimin e rekomandimit te vendmit dhe raportit te ekspertizes përkatësisht kemi prezantuar faktet për pergjegjshmerine ofertës sonë ndërsa me vendmin e datës 22.06.2026, AK nxjerr arsyetim absurd dhe i cileson atestet zyrtare si pershkrime me llogon e kompanise dhe jo ateste te prodhuesve.

Pra AK – Trepca sha, përkundër raportit te ekspertit pajtimit te vet AK-se me te njejtin raport ne proces te ri vlerësimit te ofertave ndaj ofertës sonë ne leter standarde te datës 16.06.2026, pershkruan arsyetimin e eliminimit si me poshte:

ARSYETIM

[Tenderi juaj është refuzuar] për këto arsye :

Ju jeni eliminuar nga procedura e prokurimit për shkak të mospërmbushjes së kërkesave në dosjen e tenderit, mungojn ateste për produktet e ofruara si psh. Pozicioni rroba pune, rroba pune (pantolla me kaisha dhe sako), gëzof pa jakë.

Pozicioni helmata mbrojtëse me pjesën shtesë për mbajtje të llapmpes, janë kërkuar ngjyrat: verdhë, e bardhë, blu, portokalli, kuqe, kurse ju keni dorëzuar mostren ngjyrë kafe.

Mostra e juaj nuk i përmbush kërkesat teknike të dosjes së tenderit: Çizme gome, janë kërkuar çizme gome dhe ju keni ofruar nga pvc, gjithashtu keni dhënë dy pershkrime për afat liferimi (mospërputhje brenda ofertës).

Pretendimi ankimore 1:

Certifikata e menaxhimit të cilësisë ISO 9001:2015 - certifikata nr. W-240810-Q dhe ISO 14001:2015 - certifikata nr. W-260329-E të lëshuara nga *World Quality Registrar*,

vërtetojnë se fusha e certifikimit të kompanisë sonë “Proglobal” përfshin: **Projektimin, Prodhimin dhe Shitjen e Pajisjeve Personale për Mbrojtje në Punë, Veshjeve etj.**

Atesti nr. 0045/26 i lëshuar më 12.03.2026, specifikon saktë artikujt si gëzof pa jakë G2602J, gëzof me jakë - G2602WJ dhe Jelek pa jakë G2602V. Ky atest plotëson specifikimet e kërkuara në dosjes së tenderit me përbërje 100% pambuk pëlhura e jashtme, lesh artificial rrjeta e brendshme.

Pra arsyetimi i parë i eliminimit të mungojnë atestet për rroba pune, pantollona me kemisha dhe sako është në tërësi i pa baze dhe i kunderligjeshme meqë produktet e tilla janë të atestuara nga laboratorit i akredituar ndërkombëtar **MAKKONTROL** sipas raportit nr. **022T/26 dhe 0247/25.**

Për rrobat e punës pantolla dhe sako ekziston certifikata e testimit nr. 5069/26 e cila vërteton përmbushjen e saktë të përbërjes 64.1\ PES/ 35.9 dhe peshën prej 233 g/m², brenda tolerancës prej 5%.

Për gëzofin pa jakë, certifikata e testimit nr. 5071/26 dhe artikulli W2602B dëshmon teknikisht përberjen e materialit. Për më tepër, në Dosjen e Tenderit dhe aneksin 1, nuk ishte kërkuar fare atest, por neve si OE e kemi ofruar atë bazuar në sqarimet e tenderit.

AK- Trepca sha, me rivlerësim të ofertave gjegjësisht me arsyetimin e tillë të eliminimit të kunderligjeshëm të ofertës sonë ka shkelur në tërësi dispozitat e nenit 59 dhe 72 të LPP-së, pasi që AK, paqartësit eventuale në raport me ateste ka qenë e obliguar të kërkonte sqarime dhe jo të eliminonit ofertën tonë si të pa përveçgjeshme.

Prova 1 – Atestet për rroba pune (pantolla me kaisha dhe sako) nga Laboratorit i akredituar **MAKKONTROL** i bashkangjiten ankesës.



No: 5069/26

Skopje, 02.03

CERTIFICATE of testing

1. GENERAL DATA

1.1	Product:	FABRIC FOR SUMMER BIB TROUSERS, SUMMER JACKET, SUMMER PANTS
1.2	Article:	S2602BT , S2602J, S2602P
1.3	Colour:	Dark blue
1.4	Test ordered by:	PROGLOBAL SH.P.K. 28 Nëntori LL-2, no.: 129 Prishtinë 10000, Kosovo
1.5	Sampling:	Delivered sample
1.6	Technical documentation:	International standards, and technical specifications for SUMMER BIB TROUSERS, SUMMER JACKET, SUMMER PANTS
1.7	Place and date of inspection:	Skopje, North Macedonia, March 2026 (Report No: 022T/26)

2. SCOPE OF INSPECTION

Laboratory testing

3. OVERALL INSPECTION CONCLUSION

After the Laboratory testing on the delivered sample, SUMMER BIB TROUSERS, SUMMER JACKET, SUMMER PANTS, in agreement with the requirements Technical specifications for SUMMER BIB TROUSERS, SUMMER JACKET, SUMMER PANTS.

The results of the testing are given in point 4 of this document.

Prepared by:
Liljana Peovska
Laboratory manager

Approved by:
Svetlana Kanevce
Expert



Pretendimi ankimore 2:

Per artikullin gezof pa jake, ne dosje te tenderit dhe ne aneksin 1, nuk eshte kerkuar atesti, ndersa qe me rastin e sqarimit te tenderit eshte kerku te dorezohen dhe atestet nga prodhuesi ose laborator i akredituar

Pjesa e sqarimit te TD per gezof qe AK- Trepca sha, ka potencuar:

6. Dokumentacioni teknik

Operatorët ekonomikë duhet të paragesin dokumentacionin teknik përkatës, duke përfshirë:

- Atest për materialin e jashtëm (100% pamuk) nga prodhuesi ose laborator i akredituar.
- Atest për materialin e brendshëm (lesh artificial).
- Dokument teknik që përshkruan përbërjen, gramazhën dhe karakteristikat e materialeve.

Me oferte kemi dorezu atestet për Product: Gëzof pa jakë / Gëzof me jakë / Gëzof Jelek pa jakë .

Article: G2602J, G2602WJ, G2602V

Prova 2 - Atestet dhe Dokumenti teknik për Gëzof pa jakë / Gëzof me jakë / Gëzof Jelek pa jakë – të dorezuara me oferte

No.: 00

TECHNICAL CERTIFICATE - ATEST FOR WORKWEAR FABRIC SPECIFICATION

1. GENERAL DATA

Product: Gëzof pa jakë / Gëzof me jakë / Gëzof Jelek pa jakë
Article: G2602J, G2602WJ, G2602V
Colour: Olive Green
Test ordered by: PROGLOBAL SH.P.K.
Place and date of inspection: Prishtine, KOSOVO, March 2026

2. PURPOSE OF THIS CERTIFICATE

This Technical Certificate defines the minimum technical requirements, performance criteria, and quality standards for the fabric used in the production of professional workwear.

The purpose of this document is to ensure compliance with industrial durability standards, dimensional stability, color fastness, and suitability for demanding working environments.

3. MATERIAL DESCRIPTION

Outer Fabric

- **Composition:** 100% Cotton (high-quality natural fiber)
- **Mass per unit area:** 350 g/m²
- **Properties:** Resistant to wear, moisture, water, oils, and industrial greases.
- **Colour:** Olive Green (durable against washing, fading, and intensive industrial use).

Inner Fabric (Lining)

- **Composition:** Artificial Fur / Polyester Fleece (100% PES)
- **Properties:** Provides thermal insulation and comfort during use.
- **Dimensional stability:** Resistant to deformation after washing and prolonged use.
- **Comfort:** Soft texture, suitable for daily wear in industrial working conditions.

Construction

- **Stitching:** Industrial reinforced seams, ensuring durability under intensive use.
- **Closure system:** Metal buttons, strong and suitable for industrial environments.

Pretendimi ankimore 3

Sipas pozicionit, 4 të pikës 9.1&9.2, të kërkuesve të kapacitetit teknik dhe profesional, kërkohet dorëzimi i një mostre për artikull me qellim për të vlerësuar vetitë teknike si materialin HDPE, standardin CE EN 397 dhe jo të gjitha ngjyrat e mundshme simuluese.

Mostra e dorëzuar në oferte i plotëson plotësisht specifikimet e detyrueshme të sigurisë në punë dhe se përzgjedhja dhe shpërndarja e ngjyrave sipas roleve të verdhë për punëtorët, e bardhë për menaxherët etj, specifikohet dhe dorëzohet gjatë liferimit sipas porosive, e jo në fazën e ofertimit.

Ne aneksi 1, te DT eshte kerkuar:

Ngjyra	Përdorimi
E verdhë	Punëtorët
E bardhë	Menaxherët e lartë dhe vizitorët
Blu	Inxhinierët dhe personeli teknik
Portokalli	Krye-punëtorët dhe inspektorët
E kuqe	Njësitë zjarrfikëse dhe mbrojtja civile

Pretendimi ankimore 4

Ne Aneksi 1 te DT eshte kerku qizmet e gomes te jene sipas Standardit EN ISO 20345 :2011 – S5 SRC

Me oferte kemi dorezu, qizmet e gomes te prodhuesit “EXENA” - Itali te cilat jane te certifikuara me standardin Evropian me te ri EN ISO 20345:2022 + A1 :2024 S5 **FO SR**, te cilat ofrojne siguri me te larte **sepse kane dhe nivelin e mbrojtjes FO (Fuel Oil Resistance / rezistente nga vajrat dhe karburantet).**

Gjithashtu qizmet e ofruara nga Proglobal, kane nivelin e mbrojtjes me te larte SR, ku **niveli i mbrojtjes SR permbane 3 nivele te mbrojtjes (SA, SB dhe SRC).**

Edhe ne atestin dhe catalogun e dorezuar me oferte eshte evidente se qizmet e sigurise jane nga materiali **Gome nitrile / nitrilic rubber (PVC)** qe eshte ekuivalente biles dhe me e avancuar, ka nivel te sigurise me te larte se sa eshte kerkuar ne DT.

Ky pohim i AK-se, ka ardhur me qellim te favorizmit te kompanise se rekomanduar paraprakisht.

Ne kemi ofruar çizme të prodhuesit italian EXENA S.r.l., të cilat janë të çertifikuara me standardin më të ri evropian EN ISO 20345:2022+A1:2024 - Modeli Devil Yellow S5 FO SR.

Atesti vërteton se materiali është PVC - Nitrilic Rubber - Gomë Nitrile dhe se ky material është teknikisht ekuivalent dhe më i avancuar se goma e thjeshtë, duke ofruar mbrojtje shtesë të klasës FO rezistencë ndaj vajrave dhe karburanteve dhe SR rezistencë maksimale ndaj rrëshqitjes, që tejkalon kërkesat minimale të DT-së. Pra prodhuesi posedon çertifikatat valide ISO 9001:2015 dhe ISO 14001:2015.

Prova 3 – Atesti dhe Catalogu per qizme gome – te dorezuara me oferte

Pretendimi ankimore 5

Ne dosje te tenderit, kushtet dhe kërkesat e dërgesës eshte kerkuar:

Dërgesat do të kryhet VETËM pas dhënies së "urdhër blerjes" që do të lëshohet nga Autoriteti Kontraktues, gjatë kohëzgjatjes së kësaj kontrate publike kornizë.

Kjo kontratë publike kornizë ka kohëzgjatje prej 12 muajsh dhe është efektive prej datës në të cilën ajo hyn në fuqi.


Afatin e liferimit (90 – 150) dite qe kemi ofru eshte ne kuader te LPP.

Per me teper AK dhe ne te kaluaren per rastin e ngjashem ka lidhe dhe realizu kontrate me OE me afat liferimi me dy data (40 – 90) dite.


Prova 4 – Kontrata me Agron Commerce per afatin e liferimit

Trepça Shoqëri Aksionare
Trepça Joint Stock Companies
Trepça Deoninarsko Društvo

Nr. 1076 Data. 14.02.2025
 Mitrovicë Mitrovica



Republika e Kosovës
 Republica Kosovo - Republic of Kosovo
 Qeveria - Vlada - Government



Trepça Shoqëri Aksionare
 Trepça Deoninarsko Društvo / Trepça Joint Stock Company

KONTRATË ST-159/24

Numri i kontratës¹: 12997 12998-24-13557-1-2-1/C923

Trepça S.H.A., (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërën anë; dhe
 Agron Commerce S.H.P.K., Zona Industriale, MITROVICË, (në vazhdim "Furnizuesi"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për furnizimet e shkëputura me poshtë:

Furnizimi me mjete mbrojtëse në punë me numër identifikues: 12997 12998-24-13557-1-2-1

Nëni I Lënda

1.1 Lënda e kontratës do të jetë Furnizimi me mjete mbrojtëse në punë nga Furnizuesi, i furnizimeve në vijim:

Nr.	Emri i Artikullit	Njësia	Sasia	Gjimi për njësi Pn TVSH €	TVSH %	Gjimi për njësi me TVSH €	Gjimi total me TVSH €	Vendi i origjinës	Afati i liferimit
A.Miniera me Flotacion Stanterg									
1	Çizme gome me mbrojtëse metalike	palë	500	15.25	18	18.00	9,000.00	PRC	40-90 ditë
2	Rroba pune (pantollona dhe sako)	palë	400	22.88	18	27.00	10,800.00	Eurotex-Kosove	40-90 ditë
3	Rroba pune (pantallona me Kaisha dhe sako)	Copë	150	22.88	18	27.00	4,050.00	Eurotex-Kosove	40-90 ditë
4	Këpuca pune me mbrojtje metalike	palë	200	16.95	18	20.00	4,000.00	PRC	40-90 ditë
5	Helmeta me pjesë shtesë për mbajtjen e lampes	copë	80	10.17	18	12.00	960.00	RS	40-90 ditë
6	Dorëza	palë	10000	3.05	18	3.60	36,000.00	Portwest-UK	40-90 ditë
7	Syze Mbrojtëse për Pluhur	palë	100	4.24	18	5.00	500.00	PRC	40-90 ditë
8	Maska Mbrojtëse për Pluhur	copë	100	4.24	18	5.00	500.00	PRC	40-90 ditë
9	Peshqira	copë	300	5.08	18	6.00	1,800.00	Turqi	40-90 ditë
10	Mantell pune	copë	50	11.86	18	14.00	700.00	Eurotex-Kosove	40-90 ditë

¹ Ju lutemi referojuni këtij numri të kontratës në dokumentet e futimit dhe pageses, procedurat dhe transaksionet që lidhen me thesarin.

1

Ky fakt tregon për aneshmeri, për faforizim gjegjesisht diskriminim të kompanis sonë, qëllim të caktuar dhe jo vetëm.

Pretendimi ankimore 6:

Sipas nenit 40.3 të Rregullores për Prokurimin Publik nr. 001/2022, kur një lëndë kthehet në ri-vlerësim nga OSHP-ja apo përmes pajtimit të palëve bazuar në raportin e ekspertit, AK është i obliguar që ta realizoj procesin e ri-vlerësimit dhe të nxjerrë vendimin brenda afatit ligjor prej 15 ditëve përveç nëse ka kërkuar zgjatje zyrtare për shkaqe komplekse.

Pra vendimi i OSHP-së permban datën 07.05.2026 dhe AK njoftimim mbi rezultatin e aktivitetit apo letrat standarde i keni nxjerre me daen 16.06.2026, ku ka shkelur pothuaja se dyfishin e afatit të lejuar, e keni zvarritur qëllimisht procesin për të tentuar të eliminoje ofertën tone si të pa pergjegjeshme.

Këto veprime tregojne se komisioni vlerësues nuk ka realizuar ri-vlerësim objektiv dhe në kohë, por ka marrë kohë jashtë rregullave ligjore me qëllim eliminimin e ofertës sonë dhe anulimin e tërësishëm të procedurës dhe krijimit të mundesis se re te OE te favorizuar

Pretendimi Ankimor 7:

Vendimi i AK-se, për të anuluar aktivitetin e prokurimit me arsyetime tërësisht fiktive dhe kinse në mungesë të ofertave të përgjegjshme, konsumon shkelje direkte të nenit 62 të LPP-së ku qarte përcakton rrethanat dhe mundesite se kur mund të anulohet një tender apo procedure prokurimi. Në rastin konkret, anulimi është përdorur artificialisht për të evituar kualifikimin e ofertës sonë, e cila i përmbush të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit.

Anulimi i kundërligjshëm i procedurës si dhe mosrespektimi i rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtues të OSHP-së, me të cilin AK është pajtuar zyrtarisht, përbën shkelje të rëndë të nenit 97 të Rregullores për Prokurimin Publik nr. 001/2022 dhe se ky injorim i qëllimshëm i vendimeve të OSHP-së dhe ri-vlerësimi fiktiv me qëllim eliminimi, përbën keqadministrim të rëndë të aktivitetit të prokurimit, si precedent i njohur, për anulime të tilla arbitrare dhe të pabaza.

Pretendimi Ankimor 8:

Në vendimin e AK-se, ndaj kërkesës sone për rishqyrtim të datës 22.06.2026, zyrtari përgjegjës i prokurimit ka pershkruar tekst prej vetëm dy rreshtash dhe atë fiktiv, duke deklaruar se *"në kërkesë për rishqyrtim nuk janë të sqaruara pretendimet, vetëm se keni ngarkuar disa kinse prova"*. Ky veprim përbën shkelje flagrante të nenit 108/A të LPP-së, dhe shperfaq injorancen dhe arrogance!

Veprimet e tilla bien në kundërshtim të drejtpërdrejtë me nenin 108/A të LPP-së, i cili e obligon secilin Autoritetin Kontraktues që gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve, të nxjerrë një vendim të arsyetuar i cili duhet të përmbajë arsyetimin e plotë për secilin pretendim të perfshire ne kerkese për rishqyrtim të parashtruar nga pala ankuese dhe ti sqaroj faktet dhe provave mbi të cilat është bazuar komisioni gjatë ri-vlerësimit.

Pra AK- Trepca Sha, përkatësisht zyrtari përgjegjës i prokurimit, ka shkelur këtë nen duke pershkruar se "nuk janë të sqaruara pretendimet, vetëm keni ngarkuar disa kinse prova", dhe duke injoruar plotësisht certifikatat zyrtare ISO, të kompanis sonë si prodhuese dhe raportet e testimit të çizmeve EXENA dhe laboratorit MAKKONTROL.

Kjo qasje injoruese dhe joprofesionale e komisionit dhe zyrtarit përgjegjës te prokurimit të AK-së vërteton se ri-vlerësimi ka qenë tërësisht fiktiv dhe se vendimi për anulim është marrë me qëllim të vetëm eliminimit të ofertës sonë dhe krijimit te mundesise se ri ofertimit te kompanis se favorizuar.

Si perfundim kompania jonë kërkon fillimisht nga ksperti shqyrtues i OSHP-së që në kuptim të neneve 113 dhe 114 të LPP-së, të konstatojë se kompania jone Proglobal SH.P.K. është prodhues i autorizuar i veshjeve të punës konform certifikatave ISO 9001:2015 dhe ISO 14001:2015, të lëshuara nga trupa e akredituar WQR, dhe se atestet e dorëzuara janë plotësisht valide dhe të pakundërshtueshme sipas provave qe kemi bashkangjitur edhe se çizmet e ofruara EXENA – Itali, me material gomë nitrile (PVC-8% Nitrilic Rubber) plotësojnë dhe tejkalojnë standardin e kërkuar në DT, duke qenë të certifikuara me standardin më të ri EN ISO 20345:2022+A1:2024 S5 FO SR, ne atë mënyrë qe paneli shqyrtues te nxjerri këtë:

VENDIM

- I. Te Anulohet**, vendimi i AK-së për anulim të aktivitetit të prokurimit si plotësisht fiktiv dhe arbitrar, dhe lënda të kthehet në ri-vlerësim
- II. Te urdhërphet** AK-ja që të shpërblejë me kontratë OE "Proglobal SH.P.K." si i vetmi OE i përgjegjshëm në këtë proces prokurimi dhe
- III. Te inicohet**, procedure për revokimin e certifikates ndaj zyrtarit pergejgjes te prokurimit ashtu siç percaktohet e nenin 25, par 8 te LPP-se pasi qe janë konsumuar shkelje te renda ligjore sipas nenit 97 te RrPP-se.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Te konsiderueshme

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
- b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,

- e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,
- f) Dëshminë e pagesës se tarifës se ankimit ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, dhe
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*